
GËZIM AJGERAJ

MUAJT E VITIT ME ARDIN
(POEMË)

Zvicër, 2006

Ardi i vogël ka një hall
Ka të ftohtë në janar
Rrugës për në shkollë kur ai shkon
Apo me ski kur skijon

Kur bie borë, ftohtë e acar
Pranë dritares rri shikon
Porsa të ndalen flluskat e borës
Dordolec bën në oborr

Por e do ai shumë janarin
Se e ka në shtëpi babin
Çdo ditë çmallet me kënaqësi
Bashkë me Tonin vëllanë e tij

Sa herë rrëshqet ai përmbi borë
dhe babai e shoqëron
U ka sjell nga mërgimi
Sajë e ski gjatë këtij pushimi

Kur mërdhijnë në të ftohtë
Në shtëpi e kanë më ngrohtë
Dhe mamaja aty pret
Çaj të ngrohtë mbi tryezë qet

Edhe shkurti gati shkoi
Ski e saja i tëholloi
Mbeti borës e s'u pa
Ditët shpejt ai i ha
Iku acarit e mërdhiu
Më i shkurti mbeti fatziu

Borë e akull erë e shi
I sjell marsi mbi çati
mbushet Ardi plot zemërim
Dordoleci i është shkrirë

Nis me babin plot udhëtime
Në Prekaz shkon për nderime
Ta nderojë legjendarin
Komandant Adem Jasharin

Marsi i sjell shumë përmallim
Ikën babai në mërgim
Bashkë me Tonin ulen e qajnë
Si dy zogj mallin e ndajnë

Babai letër ka dërguar
Në udhëtim mirë ka kaluar
Sa shumë Ardin e gëzoi
Letrën postieri kur ia dhuroi

Këndon këngën e pranverës
Me bilbilin maje degës
Këngë e tij plot mall mban
Në mërgim e ka babanë

Shpresa e tij vritet përditë
Ai babanë duke pritur
Rritës së tij malli përvëlon
Të fala babait kur i çon.

Kudo prilli ka gjelbëruar
Edhe lulet kanë lulëzuar
Për çdo ditë Ardi këndon
Në kopsht me mamin kur punon

Ja dhe maji sapo nisi
Në arë xha Cimi e mbjell misrin
Hedh farë dhe këndon
Bukës së re i gëzon

Edhe Ardi shumë gëzon
Për në shkollë ai kur shkon
Edhe vjershën e ka mësuar
Sa shumë mësuesin e ka gëzuar

Maji plot pesa në ditar
Bashkë me Tonin janë të parët
Në klasë kush s'ua kalon
Me sukses shumë mësojnë

Shkojnë me nxënës në shëtitje
Në rrafsh tek shpella mbi Malësi
Atje luajnë e këndojnë
Plotë argëtim ditën e çojnë

Edhe maji po mbaron
Dhe qershori po fillonte
Klasa e katërt po mbaron
Plot me pesa viti shkon

Në Malësi atje në Vërrin
Piqen degëve shumë qershori
Kalaveshët mbushullojnë
Dhe vogëlushët ëmbëltojnë

Të gjitha gëzimet në qershor
Erdhi liria në Kosovë
Flamujt nëpër sheshe
Shumë bukur valojnë

Vijnë pushimet në qershor
Mirupafshim në shtator
Shokët e klasës ai uron
Klasa e pestë neve na fton

Ikim flladeve edhe fushës

Pranë lumit lahen vogëlushët

Erdhi korriku dielli djeg
Poshtë tek lumi bën shumë freskët
Fëmijët e fshatit gumëzhijnë
Lan e luajnë mbi lëndinë

Dhe të korrave në korrik
Xixëllonja u bën dritë
Në hambarë kokrra gruri
Bukë të re korriku pruri

Fund-korriku sjell gëzime
Është koha për pushime
Vjen babai nga mërgimi
Shkëlqen Ardi nga Gëzimi

Erdhi babai, erdhi babai Në përqaftim e shuan mallin

Vapës gushti i filloi ditët
Ngrohtësinë ia vodhi korrikut
Etjes bimët i shkretton
Kjo babanë e shqetëson

Me xhaxhi Canin tek bisedon
Për bujqësinë e intereson
E do vendin të gjelbëruar
Ara e fusha të punuara
dhe atdheun të lulëzuar

Nuk pushon asnjë ditë fare
Punon në kopsht e punon në ara
Është punëtor ia kanë lakmi
S'ia kalon kush atij

Gazeta e libra shumë lexon
Ardin me shokë e këshillon
Nëpër shkolla të mësoni
Kështu atdheun e ndërtoni

U gëzohet shumë sukseseve
Por më shumë u gëzohet pesave
Ardi e Toni shumë e gëzojnë
Dëftesën e notave kur ia tregojnë

Ikën gushti fluturim
Babai i Ardit prapë në mërgim
E pret puna në dhe të huaj
Sa shumë kjo e bën të vuajë

Ardi e Toni plot pikëllim
Kur ikke babi në mërgimi
Në dhjetor i varin shpresat
Sërish babai do të kthehet

Ditë nderimi në shtator
Mbjellim lule për dëshmorë
Mësues Xhevatit e nderojmë
Veprën e tij e kujtojmë

Gumëzhijnë vogëlushët nëpër vreshta
Piqet rrushi edhe pjeshka
Edhe gjyshja zjarrin ndez
E zien rrushin për reçel

Këndon xha Cani këtë herë
Kur i mbush shishet me verë
Me rrush të kuq nga vreshta
thotë e mirë i ka dalë vera

Paska ardhur dhe tetori

Sa gëzohet xha Tomori
Kur në arë oshtin traktori
E korr misrin e e mbjell grurin
Se për dimër e bën bukën

Edhe fruta vjeshta bie
Dardhë e mollë nëpër pemë
Mbushullojnë faqet e vogëlushëve
Kur shijojnë pemë e fruta

Në kopsht mollën e mbledh mami
Do t'i ruajë kokrra babit
Flet Ardi plot përmallim
Për babanë në mërgim

Nxihet moti bie shi
Erdhi vjeshta në Malësi
Edhe lumi shumë vërshon
Ara e fusha i dëmton

Kujdes gjyshja këshillon
Në vjeshtë lumit mos iu afro
Është i ashpër asgjë s'kursen
Vërshon me vete gjithçka gjen

Në nëntor mblidhet vjeshta
Nuk ka rrush më nëpër vreshta
I pret drutë dhe xha Tomori
Po vjen dimri në prag dhjetori

Edhe gjyshja e mbush bulmetin
Po vjen dimri plot na gjeti
Plot agrume e reçel
Gati për dimër i ka zier

Ngrihen flamujt në nëntor

Ismail Qemali zbret në Vlorë
Shpalos palat e flamurit
Marigonës i bekon duart

Bashkë me festën erdhi dhjetori
Gëzon Ardi te oborri
Një flamur e mban në duar
Me shok festën duke festuar

Ardi e Toni numërojnë çdo ditë
Babanë duke pritur
Sa i gëzon mes-dhjetori
Kur hyn babai te oborri

Sa shumë mbushen plot gëzim
E i hidhen në përqafim
Çmallet babi kur i shikonte
Rritën e tyre e numëronte

Dhe vogëlushët shumë e gëzojnë
Atij notat kur i tregojnë
Kanë plot pesa në ditar
Në klasë të tyre janë të parët

Iku e shkoi dhe ky vit
Ai u plak, Ardi bashkë u rrit
Tani shkojnë në klasë të pestë
Vitin e ri aty ta presë

13 prill 2006, Zvicër

Gëzim AJGERAJ, u lind në Malësi të Vërrinit më 6 gusht të vitit 1967. Ka botuar këta libra: **1. "Klithmë malli"**, poezi, „Rilindja“, Prishtinë, 1997; **2. "Ëndrra për parajsë"**, poezi, „Rilindja“, Prishtinë, 1998; **3. "Qielit po digjem"**, poezi, „Rilindja“, Prishtinë, 1998; **4. "Flakë në plagë"**, poezi, „Rilindja“, Prishtinë, 1998; **5. "Kënga e babait"**, poezi për fëmijë, „Apolonia“, Prishtinë, 1998; **6. "Urti popullorë të Vërrinit" 1** (bashkautorësi), „Apolonia“, Prishtinë, 1998; **7. "Mallëngjimi"**, poezi, „Rilindja“, 2000; **8. "Balada e Vërrinit"**, Kl. „F. S. Noli“, Prizren, 2001; **9. "Rruga e lirisë"**, dramë, „Meshari“ Prishtinë, 2001; **10. "Rruga e lirisë" - Intervistë me Zafir Berishën**, botoi Asociacioni i Veteranëve të ish-UÇK-së – Prizren, 2002; **11. "Atdheu në trastë"**, cikël me poezi, botoi revista letrare "Jeta e re" nr. 4, korrik-gusht 2002, viti LIV. Prishtinë; **12. "Pëllumbat e lirisë"**, novelë për fëmijë, Edicioni i revistës "Fidani", Prizren, 2004; **13. "Ditët e bardha"**, novelë për fëmijë, Edicioni i revistës "Fidani", Prizren, 2004; **14. "Atdheu i copëtuar"**, cikël me poezi, në librin **"Pikoi molla gjak"** (Lirikë me motive arvanitase), botoi MKRSCJR-Departamenti i Çështjeve Jorezidente, Prishtinë, 2004; **15. Cikël me poezi "Udhë e zjarmi"**, në librin "Muzat i bien lyrës", Edicioni i revistës "Fidani", Prizren, 2005; **16. "Lulëkuqet e Vërrinit"**, poezi, botoi shtëpia botuese "Metafora", Zvicër, 2005; Ka bashkëpunuar dhe bashkëpunon me të gjitha gazetat dhe revistat e kohës, si: "Rilindja", Zvicër - Prishtinë, "Bujku", Prishtinë, "Zëri i Kosovës", Zvicër - Prishtinë, "Bota sot", Zvicër, "Koha ditore", Prishtinë, "Epoka e re", Prishtinë, "Zëri", Prishtinë, "Fakti", Shkup, "Ars", Tiranë, "Pena shqiptare", Prishtinë, "Pionieri", Prishtinë, "Zogu i mëngjesit", Prishtinë, etj. Është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës në Prishtinë. Që nga 23 marsi 2002, është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Zvicrës (SSV). Jeton dhe vepron në Zvicër.

Libra të tjerë:

17. *Zana në mërgim*, poezi për fëmijë, "Metafora", Zvicër, 2006;
 18. *Huqet e Benit*, poezi për fëmijë, "Metafora", Zvicër, 2006;
 19. *Bosi lepurushi, fabula*, "Metafora", Zvicër, 2006;
 20. *Gjëgjeza*, "Metafora", Zvicër, 2006;
 21. *Dita me Tonin* (Poemë), "Metafora", Zvicër, 2006;
 22. *Muajt e vitit me Ardin* (Poemë), "Metafora", Zvicër, 2006;
- Që nga janari i vitit 2004, editon revistën **"Metafora poetike"**, Editorial i poetit që del në çdo tre muaj.

Gëzim Ajgeraj
MUAJT E VITIT ME ARDIN

(POEMË)

Lektor: Ilam Berisha

Ilustrimet:

Radhitja kompjuterike: Ardian Ajgeraj

36 faqe: 19,5 cm.

Tirazhi: 500

Të drejtat e rezervuara për autorin

GA 19670608-06-22